

INTERMEDIATION IN FINANCE

Redon Koleci

University College BIZNESI Prishtina - Kosovo, redon_koleci@hotmail.com

Abstract: Financial institutions are financial intermediaries in the process of transferring financial funds between participants in the financial system. The key participants in the financial system are: individuals, businesses, financial intermediaries and the government.

Money holders are interested in investing their savings in earning income. As compensation for this, they earn profits in various forms, such as interests, dividends, capital gains, etc. Also, borrowers need additional financial funds to finance their investment or consumption programs. They are obliged to borrow those funds from financial institutions. For lending funds they pay a certain lender's price.

With the intermediation of financial institutions, it is possible to transfer financial funds from entities that have surplus to entities lacking financial funds and at the same time need to be provided from external investment or consumption sources, if the accumulation of sufficient financial resources from own resources.

The essence of financial intermediation lies in the collection of financial funds from many individuals and businesses that own financial savings, and their investment in various forms. With the disclosure of the financial intermediation process, we note its multidimensional aspect, on the one hand, as a pool of financial funds in various forms and their concentration, while on the other hand, as investment of shelled funds through various forms of loans to borrowers who need funding.

Keywords: Financial institutions, brokers, funds, borrowings, investments.

NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Redon Koleci

Kolegji Universitar BIZNESI Prishtinë – Kosovë, redon_koleci@hotmail.com

Abstrakt: Institucionet financiare janë ndërmjetsit financiar në procesin e kalimit të fondeve financiare ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin financiar. Pjesëmarrësit kryesor në sistemin financiar janë: individët, bizneset, ndërmjetësit financiar dhe qeveria.

Zotëruesit e parasë janë të interesuar t'i investojn kursimet e tyre për të fituar të ardhura. Si kompensim për këtë, ata nxjerrin fitime në forma të ndryshme, si interesa, dividendë, fitime kapitale etj. Po ashtu, huamarrësit kanë nevojë për fonde financiare shtesë për financimin e programeve të tyre të investimit apo konsumit. Ata janë të detyruar që ato fonde t'i huazojnë nga institucionet financiare. Për fondet e huazura ata u paguajnë një çmim të caktuar huadhënësve.

Me ndërmjetësimin e instituioneve financiare bëhet e mundur kalim i fondeve financiare nga subjektet që kanë teprica në subjektet që kanë mungesë të fondeve financiare, dhe që njëherësh kanë nevojë për sigurimin e tyre nga burimet eksterne të investimit apo të konsumit, se po të pritej akumulimi i mjaftueshëm i fondeve të nevojshme financiare nga burimet vetjake.

Esenca e ndërmjetimit financiar qëndron në mbledhjen e fondeve financiare nga shumë individ dhe biznese që zotërojnë kursime financiare, dhe investimin e tyre në forma të ndryshme. Me shpalosjen e procesit të ndërmjetimit financiar e vëmë re aspektin shumëdimensional të tij, në njërin anë si grumbullim të fondeve financiare në forma të ndryshme dhe përqendrim të tyre, kurse në anën tjetër si investime të fondeve të grumbulluara përmes formave të ndryshme të huave huamarrësve që kanë nevojë për fonde financiare.

Fjalët kyçe: Institucionet financiare, ndërmjetësit, fondet, huazimet, investimet.

HYRJE

Institucionet financiare nuk e kanë vetëm rolin e ndërmjetimit të thjeshtë, ngase ato kryejnë edhe një vag të tërë analizash dhe vlerësimesh me rastin e krijimit, ofrimit dhe kryerjes së shërbimeve të tyre, si nga aspekti i grumbullimit dhe përqendrimit të fondeve financiare, ashtu edhe nga aspekti i investimeve të potencialeve të formave financiare.

Në aspektin e grumbullimit të fondeve . analiza ka për qëllim të vlerësojë përshtatshmerinë e burimeve financiare në pikpamje të normës së interesit dhe të afatit të shfrytëzimit të tyre, kurse në aspektin e investimit të potencialeve financiar, analiza ka për qëllim të konstatojë dhe të përcaktoj arsyeshmerinë ekonomike dhe financiare të financimit të projektve investuese, dhe të mundësive reale për kthim e fondeve të investuara , së bashku me një normë të caktuar të interesit.

Zotëruesit e kursimeve, mundë t'i investojnë ato edhe në menyrë të drejtëpërdrejt te përdoruesit që kanë nevojë për fonde financiare. Ata mund t'ia huazojnë ato edhe qeverisë për financimin e programeve plotësuese të konsumit buxhetor. Në rastin e prë kemi të bëjmë me emetimin e aksioneve dhe obligacioneve nga ana e shoqëris që kanë nevojë për fonde financiare, kurse në të dytin me obligacione të qeverisë, përmes të cilave qeveria siguron fonde financiare për financimin e deficitit buxhetor.

Duke përmbledhur, institucione financiare (ndërmjetësit financiar) mundësojnë grumbullimin e kursimeve financiare të bizneseve dhe individëve, si dhe investimin e tyre në forma të ndryshme të ndryshueshme për financimin e programeve zhvillimore dhe të konsumit. Duke e kryer këtë funksion, institucione financiare ndikonë në optimalizimin e efekteve ekonomike-financiare dhe në rritjen e efikasitetit në shkallë mikro dhe makroekonomike.¹¹⁷

2. NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Në jetën ekonomike përherë janë preznetë transaksionet financiare suficitarë/ subjektet që në momentin e caktuar e kanë më shumë sesa janë nevojat e tyre/ dhe transaktorët deficitarë. Një prej funksioneve të bankës është që në mes transaktorëve suficitarë dhe deficitarë të ndërmjetësojë me qëllim që të bëhet shfrytëzimi sa më optimal i mjeteve financiare dhe i sigurimit të zhvillimit të papenguar të procesit të riprodhimit .

- Zakonisht procesi në fjalë zhvillohet sipas një rrjedhe dhe procedure të caktuar gjatë së cilës mjete e kursyera financiare transferohen nga transaktorët suficitarë financiar te transaktorët financiar deficitarë

- Zhvillimi i procesit të përshkruar varet nga shumë faktore por në rend të parë nga zhvillimi i performansave financiare të subjekteve ekonomike . Respektivisht zhvillimi i një ndërmarrje ekonomike mundë të jetë fryt i:

1. Vetëfinancimit ose i financimit intern

2. Financimit direkt ose investimit aksionar

3. Financimit indirekt ose me anë të shfrytëzimit të kredive.¹¹⁸

Vetëfinancimi

ose financimi intern për bankat dhe ndërmjetësit financiar nuk paraqet ndonjë sferë të interesimit të veçantë , për arsye se në këto raste nuk kemi të bëjmë me transferin e mjeteve të kursyera në mes të transaktorëve.

- Vetëfinancimi është karakteristik për ndërmarrjet që kanë performansat financiare në nivele shumë të larta gjë që është rezultat i kushteve strukturore makroekonomike dhe faktorëve mikroekonomik. Në fazatë më tutje kur subjekti ekonomik arrin të zhvillohet dhe të stabilizoj pozitën e saj në tregë, subjekte ekonomike preferojnë shfrytëzimin e metodave të vetfinancimit dhe e zvogëlojnë shfrytëzimin e mjeteve të huaja dhe të kredive. Mundë të pohojmë se varësisht nga kushtet konkrete dhe interesi i subjekteve ekonomike shfrytëzojnë metodat direkte dhe indirekte të financimit.

Financimi direkt

Metoda e financimit direkt për bankat dhe shkencën mbi ndërmjetësit financiarë kanë një rëndësi sekondare, respektivisht proporcionale me rolin dhe rëndësin që luan banka dhe tregu financiar në emetimin, distribuimin dhe qarkullimin e aksioneve dhe subjekteve ekonomike . Në rastet e financimit direkt, vrojtuar nga prizmi i subjektit afarist por edhe nga i bankës është fjala për metodën e përzier të angazhimit të burimeve financiare në zhvillimin e subjektit afarist , me 0' rastë dalin sheshit dhe zhfrytëzohen instrumentet financiare e qarkullimit të instrumenteve financiare në trefun e kapitalit financiar , interesit financiar, kamtës , dividendës etj. Në rastë se se i zhfrytëzojnë instrumentet e kreditimit siç janë:

- Kreditë e huazuara drejtëpërdrejtë nga transaktorët suficitarë financiar dhe
- Letrat me vlerë të emetuara, letrat komerciale

¹¹⁷ Bundo Sherif , Financë botimi i tretë , Tiranë 2007

¹¹⁸ Paca Agim, Recenset Dr.Sc Isa Mustafa, Bankat dhe Sistemi bankar, Prishtinë 2005, faqe 50

Nesë shfrytëzohen këto instrumente dhe forma ma të kreditimit / huazimit, si rezultat do të ndodhë të shtohen borxhi dhe huaja .

Financimi indirekt

Finacimi indirekt , po shtu kuptohet një mardhënjë në mes kreditorëve dhe debitorëve . Procesi në fjalë zhvillohet në kuadër të sistemit Bankar. Mekanizmi i financimit indirekt dhe i procesit të akordimit të huas si dhe i pagimit të saj në kuadër të sistemit bankar është i përcaktuar dhe konkret. Mekanizmi në fjalë është i përbërë edhe në mes huadhënsit dhe huamarrësit shfaqen një e më shumë ndërmjetës finaciar/banka.

Gjatë këtij procesi bankat e kryejnë funksionin primarë respektivisht e kryejnë transferimin e mjeteve financiare të kursyera. Shikuar nga aspekti mikroekonomik procesi i kreditimit/huadhënsjes dhe i huamarrjes/përshkruhet me anë të zhvillimit të saj në dy etapa në etapan a parë subjektet ekonomike dhe transaktorët fianciar suficitarë deponojnë në bankë, faktikisht i dorzojnë paratë e gatshme në bankë dhe për kundër vlerë nga banka prapjnë librezën e kursimit. Ndërsa nga ana tjetër banaka që në momenti i pranimit të parave të kursyera për sasin dhe vlerën e njejtë të parave të kursyera do të terheq ato në qarkullim duke i zvogëluar në të njëjtën kohë edhe me masën e paras në qarkullim.

Në ndonjë moment tjetër kohor subjekte deficitare financiare paraqiten me kërkesë.¹¹⁹

3. FUNKSIONET E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

Më sipër përmendum se tregjet financiare e lehtësojnë kalimin e fondeve fianciare nga ata që disponojnë kursime monetare tek ata që investojnë paratë në aktivet kapitale. Kursimet shpërndahen midis investimeve dhe shpenzimeve, përmes tregtimit të letrave në vlerë në tregjet financiare. Funksionet e institucioneve fianciare ndërmjetëse konkretizohen përmes kontributit të tyre në lehtësimin dhe përmirësimin e kalimit dhe të distributimit të fondeve financiare në shumë forma dhe në shume aspekte. Funksionet themelore të ndërmjetesimit financiar janë:

- Mekanizmi i pagesave
- Tregtimi i letrave me vlerë
- Ekonomizimet e shkallës
- Harmonizimi i maturitetit dhe likuiditetit
- Shpërndarja e riskut
- Menaxhmenti i portfolit
- Tatimi i diferencuar mbi të ardhurat

Mekanizmi i pagesave

Nëpërmjet institucioneve financiare realizohet sistemi i pagesave dhe kalimi i fondeve nga huadhënsi tek huamarrësi në një vend të përcaktuar, që siguron mundësin e informacionit si për huamrësin ashtu edhe për huadhënsin. Nëpërmjet ndërmjetësimit financiar, zotëruesit e kursimeve monetare dhe huamarrësit i optimizojnë kushtet e transaksioneve financiare, duke u udhëhequr nga volitshmëria e transaksioneve.

Tregtimi i letrave me vlerë

Institucionet financiare ndërmjetëse ndihmojnë në procesin e shitjes dhe blerjes së letrave me vlerë. Ato janë specializuar për tregtimin e letrave të caktuara me vlerë, disponojnë me informacion të mjaftueshëm për tregjet potenciale, dhe disponojnë me personel profesional për përdorimin dhe vlerësimin e instrumenteve të caktuara financiare.

Ekonomizimet e shkallës

Nga ana tjetër çdo transaksion huadhënie dhe huamarrje ka koston e vet që përgjithësisht është fiks. Sa më i madh të jetë vëllimi i transaksioneve aq më e vogël është kosto për njësi . Është e qartë se kur marrim një hua të madhe nga një bankë kushton shume më lirë në vend që ta marrim atë nga disa individë. Ndërmjetësit financiar duke grumbulluar fondet e individëve përfotojnë edhe epërsinë e investimeve në shkallë të gjerë , të cilat individët që zotërojnë këto fonde nuk kanë mundësi që t'i realizojnë. Institucionet financiare, në krahasim me financimin direkt realizojnë edhe një sërë shërbimesh të tjera ndaj huadhënsve dhe huamrësve.

Harmonizimi i maturitetit dhe likuiditetit

¹¹⁹ Paca Agim, Recenset Dr.Sc Isa Mustafa, Bankat dhe Sistemi bankar, Prishtinë 2005, faqe 50

Firmat financiare duke pranuar depozita me afat të ndryshme maturimi dhe duke dhënë hua ose investuar në instrumente financiare të ndryshme, kanë shumë më tepër mundësi të sigurojnë një harmonizim midis afateve të ndryshme të maturimit të aktiveve dhe pasiveve të tyre. Nëpërmjet këtij harmonizimi firmat financiare sigurojnë edhe një shkallë të caktuar likuiditeti, sepse firma financiare i krijon depozituesve mundësinë e tërheqjes së parave të dhëna hua në afate më të shkurtra se sa afati i kredive. Pavarësisht nga preferencat e ndryshme të depozituesve dhe huamrësve, ekziston prirja që depozituesit të synojnë afate sa më të shkurtra dhe huamarrësi afate sa më të gjata maturimi. Pra Ndërmjetësit financiarë bënë të mundur që depozitat afat shkurtra të konvertohen në kredi afatgjata.

Shpërndarja e riskut

Ndërmjetësi financiar zvogëlon në mënyrë të dukshme riskun e mosshlyerjes së kredisë duke e shpërndarë atë në individ të ndryshëm. Shpërndarja e riskut bëhet si për aktivet ashtu edhe për pasivet. Baza e minimizimit të riskut nga firma financiare qëndron në ligjin e njohur të numrave të mëdhenjë.¹²⁰

PËRFUNDIMI

Në këtë punim shkencor është paraqitur e gjithë puna dhe funksioni i ndërmjetësve në përgjithësi si dhe roli i tyre që bëjnë dhe ndikojnë në sistemin financiar dhe sidomos benefitet që i sjellin shoqëris në përgjithësi.

Institucionet financiare kryejnë dhe një formë specifike të ndërmjetësimit, në bazë të mbajtjes dhe udhëheqjes së depozitave transaktive të individëve, bizneseve dhe qeverive.

Depozitat transaktive paraqesin bazën mbi të cilën kryhet qarkullimi i të gjitha pagesave me përdorimin e urdhëresave për regjistrime në llogari.

Po ashtu, në bazë të këtyre depozitave, bankat si bartëse të tyre mund të lejojnë kredi afatshkurtra, për bizneset dhe individët.

Ne do të përdorim emërtimin “depozita transaktive” për atë pjesë të depozitave në llogaritë që zakonisht kategorizohen si “llogari rrjedhëse e korrespondencës”. Në vendet me ekonomi të zhvilluar, institucionet financiare kanë arritur një shkallë të lartë të zhvillimit dhe të organizimit.

Ato i karakterizon shkalla e lartë e përsosjes në kryerjen e shërbimeve financiare, rritja e shpejtë e gamës së shërbimeve financiare, aplikimi i inovacioneve në aspektin e operacioneve dhe të transaksioneve, shpejtësia e madhe e kryerjes së shërbimeve dhe aplikimi i teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe të telekomunikacionit. Nga pikëpamja e ekonomisë në tërësi, transferimi indirekt i fondeve nga zotëruesit tek firmat, nëpërmjet ndërmjetësve financiarë, është më i rëndësishëm se sa kalimi në mënyrë direkt i tyre, në formë të shitjes së letrave të reja me vlerë, ose investimeve në partnership.

Janë të shumta përparësitë e sistemit të ndërmjetësimit financiar për huamarrësit, huadhënësit (zotëruesit e parasë), ndërmjetësit financiarë dhe për ekonominë në tërësi.

Ndërmjetësi financiar është i aftë të mbledhë fondet nga shumë individ dhe firma, duke krijuar kështu potenciale të konsiderueshme financiare, dhe duke e dhënë huan në një masë të konsiderueshme. Për shembull, banka mbledh depozitat e shumë zotëruesve duke krijuar fonde më të mëdha financiare, të vlefshme për t'i dhënë hua.

LITERATURA

- [1] Bundo Sherif, Financë botimi i tretë, Tiranë 2007
- [2] Paca Agim, Recenset Dr.Sc Isa Mustafa, Bankat dhe Sistemi bankar, Prishtinë 2005, faqe 50
- [3] Xhafa Halit dhe Ciceri Beshmir, Drejtimi Financiar botimi i tretë, Tiranë 2006

¹²⁰ Xhafa Halit dhe Ciceri Beshmir, Drejtimi Financiar botimi i tretë, Tiranë 2006